



DISPOZITAT E **ZEKATIT TË FITRIT**

AGRON KRASNIQI

Titulli

Dispozitat e Zekatit të Fitrit

Autor

Agron Milazim Krasniqi

Redaktor gjuhësor

Jeton Koçinaj

Dispozitat e zekatit të fitrit

- Hyrje
- Ç'është zekati i fitrit?
- Gjikimi për zekatin e fitrit
- Urtësia e tij
- Koha e dhënies së këtij zekati
- Për kë është obligim?
- Kujt i takon zekati i fitrit?
- Sasia që duhet dhënë
- Llojet e ushqimeve që mund të jepen për zekat
- A lejohet të jepen të holla në vend të ushqimit?

Hyrje

Falënderimi dhe lavdërimi i takojnë Allahut, Zotit të botëve, Krijuesit të gjithçkaje, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit.

Paqja dhe lavdërimi i Allahut qofshin mbi të Dërguarin, familjen e shokët e tij, si dhe mbi të gjithë ata që pasojnë rrugën e tij deri në mbarim. Më pas:

Ky shkrim i shkurtër rreth zekatit të fitrit përmban në vete dispozitat kryesore që kanë të bëjnë me këtë adhurim.

Lus Allahun e Lartësuar ta bëjë të dobishëm!

Ç'është zekati i fitrit?

Zekati i fitrit, apo *sadakatul fitri*, te ne njihet si “vitrat”, gjegjësisht “dhënia e vitrave”.

Fjala “fitr” d.m.th. çelje apo prishje, e kundërta e agjërimit; prej kësaj rrjedh edhe fjala iftar, pra, të bësh iftar, të hash ushqim.

Së këndejmi, zekati i fitrit është sadaka që duhet dhënë me rastin e përfundimit të agjërimit të muajit Ramazan.

Gjykimi për zekatin i fitrit.

Dhënia e zekatit të fitrit është obligim. Argument për këtë është Kurani, Suneti profetik dhe ixhmai (konsensusi) i dijetarëve muslimanë.

Nga Kurani: Allahu i Lartësuar thotë në Kuran: **“Falni namazin dhe jepni zekatin.”** (El Bekare, 43) Në zekatin e përgjithshëm hyn edhe zekati i fitrit.

Po ashtu thotë: **“Ka shpëtuar ai që është pastruar. Që përmend emrin e Zotit të vet dhe falet.”** (El Ala, 14-15)

Disa komentues të Kuranit nga radhët e selefëve kanë thënë: *“Është për qëllim ai që e ka dhënë zekatin e fitrit, pastaj ka falur namazin.”* (Shih: *Tefsir Ibn Ebi Hatim*, 1-3418)

Nga Suneti profetik: Abdullah ibn Omeri (radijallahu anhumu) thotë: *“I Dërguari i Allahut (sal-lallahu alejhi ue selem) e ka obliguar zekatin e fitrit: një saë hurma (njësi matëse) ose një saë thekër, për muslimanin rob dhe të lirë, mashkull dhe femër, të vogël dhe të madh.”* (Shënon Buhariu, 1503, dhe Muslimi, 984).

Ixhmai (konsensusi) i dijetarëve: Imam Ibn el Mundhiri thotë: *“Dijetarët janë të një mendimi se zekati i fitrit është farz (obligim).”* (Shih: *El Ixhma*, f. 47)

Urtësia e tij

Ibn Abasi (radijallahu anhu) thotë: *“I Dërguari i Allahut (sal-lallahu alejhi ue selem) e ka bërë obligim zekatin e fitrit: pastrim për agjëruesin nga fjalët e kota dhe shprehjet e pista, si dhe ushqim për të varfrit.”* (Shënon Ebu Davudi, 1609, Ibn Maxhe, 1827 etj. Hadithi është i saktë.)

Pra, urtësia e dhënies së zekatit të fitrit është:

Së pari: pastrim apo shpagim për agjëruesin nga gjynahet apo fjalët e kota e të pavlera që mund t'i ketë thënë, qoftë edhe pa qëllim, si dhe nga shprehjet e ulëta, të turpshme apo të ndyta që mund të kenë dalë nga ai gjatë kohës sa ka qenë agjërueshëm.

Së dyti: ushqim për të varfrit, në mënyrë që t'i shoqërojnë të pasurit në këtë ditë gëzimi.

Koha e dhënies së këtij zekati

Sa i përket kohës se kur duhet nxjerrë zekati i fitrit, mund ta ndajmë në disa kategori:

1. Koha e obligueshme për dhënien e zekatit fillon me perëndimin e diellit natën e Bajramit. Ky është mendimi i Sufjan eth Theuriut, Is'hakut, njëri mendim i Malikut, Ahmedit dhe Shafiut. Ndërkaq, sipas Ebu Hanifes dhe Malikut, në mendimin e tij të dytë, kjo kohë fillon pas hyrjes së agimit ditën e Bajramit.

2. Koha e pëlqyer (mustehab) është para daljes për namaz të Bajramit, bazuar në hadithin e Ibn Omerit (radijallahu anhu), që thotë: *“... si dhe (i Dërguari) ka urdhëruar që fitri të jepet para se njerëzit*

të dalin për namaz.” (Shënon Buhariu, 1503)

3. A lejohet që zekati i fitrit të jepet para kohës? Po, lejohet të jepet dy ose tri ditë para Bajramit.

Argument për këtë është hadithi që shënon Buhariu (2311), përcjellë nga Ebu Hurejra (radijallahu anhu) se i Dërguari (sal-lallahu alejhi ue selem) e autorizoi atë të ruante zekatin e Ramazanit. Kështu, tri net me radhë atij i vajti një person duke tentuar të merrte nga zekati, derisa Ebu Hurejra e kapi atë dhe deshi ta dërgonte tek i Dërguari (sal-lallahu alejhi ue selem) ... deri në fund të hadithit.

Ndërkaq, argumenti në këtë hadith qëndron se, gjatë tri netëve u përsërit e njëjta ngjarje, gjë që tregon se tri net para

Bajramit Ebu Hurejra ishte duke ruajtur zekatin e fitrit, pra, kishin grumbulluar tri ditë para kohës.

Gjithashtu, praktika e shokëve të të Dërguarit (sahabëve) ishte se e grumbullonin zekatin e fitrit dy apo tri ditë para Bajramit.

Abdullah ibn Omeri thotë: “... dhe (sahabët) e jepnin atë para Bajramit, një apo dy ditë.” (Shënon Buhariu, 1511). Imam Ibn Kudame thotë: “Kjo aludon se të gjithë vepronin kështu, andaj kjo është *ixhma* (konsensus).”

Nuk preferohet dhënia e zekatit para kohës më shumë se tri ditë, përveç në rast nevoje apo domosdoshmërie. Allahu e di më mirë.

4. Vonimi i tij. Nuk preferohet të vonohet pas namazit të Bajramit.

Ai që e vonon atë pas namazit, e ka lënë atë që është më e mirë, pra, ka lënë Sunetin. Kjo, se qëllimi i fitrit është që të pasurohen të varfrit para Bajramit, ashtu që të mos u lypin njerëzve atë ditë.

Këtë mendim kishte Ata ibn Ebi Rabah, Ebu Hanife, Maliku, Musa ibn Verdani, Is'haku, Ahmedi etj.

Bazuar në hadithin e Ibn Abasit (radijallahu anhu) që thotë: *“Ai që e jep para namazit të Bajramit, ajo është sadakë e pranuar, e, kush e vonon pas namazit, ajo është thjesht sadaka.”* (Shënon Ebu Davudi, 1609, dhe Ibn Maxhe, 1827)

E, nëse e vonon pas ditës së parë të Bajramit, sipas shumicës së dijetarëve, ka

bërë mëkat dhe ka kundërshtuar Sunetin profetik, andaj obligohet që ta kompensojë atë menjëherë. (Shih: *El Mugni mea esh Sherh el Kebir*, 2/676)

Për kë është obligim?

Zekatin e fitrit obligohet ta japë çdo musliman, qoftë i vogël apo i rritur, i lirë apo i robëruar, femër apo mashkull, i cili ka mundësi ekonomike, ashtu që i plotëson nevojat e tij dhe të atyre që i ka nën përkujdesje ditën e Bajramit si dhe i mbetet tepricë.

Pra, secili musliman duhet ta japë fitrin për vete dhe për ata që i ka nën përkujdesje e të cilët i ka obligim për t'i furnizuar, si: gruan dhe fëmijët, apo ndonjë të afërm që e ka nën përkujdesje e që s'ka mundësi vetë ta japë atë.

Fëmijët e rritur që kanë pasuri të tyre personale (punë, rrogë etj.) duhet ta japin vetë, e, nëse s'kanë mundësi, atëherë për ta e jep babai i tyre.

Fitri mund të jepet edhe për fëmijën në barkun e nënës (embrionin), mirëpo nuk është obligim. Ndërkaq, transmetimi, sipas të cilit Othmani (radijallahu anhu) e jepte edhe për embrionin, nuk është i saktë.

Lejohet që dikush të autorizojë dikë tjetër për të dhënë zekatin në emër të tij.

Zekati i fitrit lejohet të dërgohet në ndonjë vend tjetër në rast nevojë.

Çështje: nuk është kusht që të ketë masë të caktuar të pasurisë, mirëpo mjafton të ketë furnizimin e ditës përkatëse për veten e familjen dhe të ketë teprice sa për të dhënë zekatin në fjalë. Ky është mendimi i shumicës së dijetarëve, si: *nga sahabët*: Ebu Hurejra (radijallahu anhu); *nga tabiinët*: Ebul Alije, Shabiu, Ata ibn Ebi Rabah, Muhamed ibn Sirini, Hasan

el Basriu, Zuhriu; nga imamët: Maliku, Shafiu, Ahmedi, Ebu Theuriu etj.

Abdullah ibn Omeri (radijallahu anhu) transmeton: *“I Dërguari i Allahut (sal-lallahu alejhi ue selem) e ka obliguar zekatin e fitrit: një saë hurma (njësi matëse) ose një saë thekër, për muslimanin rob dhe të lirë, mashkull dhe femër, të vogël dhe të madh.”* (Shënon Buhariu, 1503, dhe Muslimi, 984)

Imam Begaviu thotë: *“Ky hadith është argument se nisabi (masë e caktuar e pasurisë në të cilën obligohet të jepet zekati) nuk është kusht për të dhënë zekatin e fitrit.”*

Thalebe ibn Suajri, ky nga babai i tij, transmeton se i Dërguari (sal-lallahu alejhi ue selem) ka thënë: *“Jepeni zekatin e fitrit një saë nga gruri për çdo dy*

persona, të vegjël apo të rritur, meshkuj apo femra, të lirë apo të robëruar, të varfër apo të pasur. Sa për të pasurin tuaj, atë e pastron Allahu, kurse të varfrit tuaj do t'i kthehet më tepër seç e ka dhënë.” (Shënon Ahmedi, 23664, Ebu Davudi, 1619, Tahaviu, 3411, etj.)

Në një transmetim tjetër, të Ebu Davudit (1620), qëndron: *“Për çdo person.”*

Nga Ebu Hurejra (radijallahu anhu) transmetohet: *“Zekati i fitrit është obligim për çdo të pasur e të varfër.”* (Shënon Abdurrezaku në *El Musanef*)

Në këto hadithe nuk bëhet dallim mes të varfrit apo të pasurit në obligueshmërinë e zekatit të fitrit, andaj çdokush që ka mundësi, e ka për detyrë ta jap atë.

Kujt i takon zekati i fitrit?

Zekatin e fitrit ka të drejtë ta marrë çdokush që është nevojtar, që ka kushte të dobëta ekonomike, ashtu që, të hyrat që ka, nuk i mjaftojnë për të kaluar muajin ose, të hyrat që ka, janë më të pakta se nevojat apo shpenzimet e tij, bazuar në hadithn e Ibn Abasit (radijallahu anhu), që thotë: *“I Dërguari i Allahut (sal-lallahu alejhi ue selem) e ka bërë obligim zekatin e fitrit: pastrim për agjëruesin nga fjalët e kota dhe shprehjet e pista, si dhe ushqim për të varfrit (nevojtarët).”* (Shënon Ebu Davudi, 1609; Ibn Maxhe, 1827, etj. Hadithi është i saktë.)

Shumica e dijetarëve thonë se zekati i fitrit u jepet të gjitha shtresave që u jepet

zekati i pasurisë, përkatësisht zekati vjetor, bazuar në ajetin kuranor:

“Allahu caktoi obligim që lëmosha (zekati etj.) t’u takojnë vetëm: të varfërve (nevojtarëve), të ngratëve (që s’kanë fare), punonjësve (që e tubojnë), atyre që duhen përfituar zemrat (të dobëtëve në besim), e duhet dhënë edhe për lirim nga robëria, të mbyturve në borxhe, (luftëtarëve), në rrugën e Allahut dhe atij që ka mbetur në rrugë. Allahu e di gjendjen e robërve, punon sipas urtësisë së Vet.”
(Et Teube, 60)

Sasia që duhet dhënë

Abdullah ibn Omeri (radijallahu anhumu) thotë: *“I Dërguari i Allahut (sal-lallahu alejhi ue selem) e ka obliguar zekatin e fitrit: një saë hurma (njësi matëse) ose një saë thekër, për muslimanin rob dhe të lirë, mashkull dhe femër, të vogël dhe të madh.”* (Shënon Buhariu, 1503, dhe Muslimi, 984)

Ebu Seid el Hudriu (radijallahu anhu) thotë: *“Në kohën e të Dërguarit (sal-lallahu alejhi ue selem) jepnim zekatin e fitrit një saë ushqim, një saë thekër, një saë hurma, një saë nga ekiti (lloj djathi i thatë i përfiturar prej kosit) një saë rrush të thatë.”* (Buhariu, 1506)

Vlera e një sai është e barabartë me katër palë grushte të mbushura plot, shprehur në kilogram, mund të

ndryshojë, varësisht nga ajo që mat, që mesatarisht i bie **2.50 kg (dy kilogramë e gjysmë)**.

Llojet e ushqimeve që mund të jepen për zekat

Në dy hadithet e lartcekura u përmenden disa ushqime që ishin traditë në atë kohë në Medinë, si: hurma, thekra, rrushi i thatë, lloj djathi i thatë. Në disa transmetime të tjera përmendet edhe gruri.

Nisur nga kjo, shumica e dijetarëve thonë se lejohet të jepen të gjitha llojet e ushqimeve që përdoren si ushqim tradicional në një vend të caktuar.

Si rregull apo kriter të ushqimit thonë: çdo ushqim që përdoret në një vend (القوت), ushqim ky i cili mund të matet dhe të ruhet pa u prishur për një kohë të gjatë. Te ne mund të theksohet: gruri, mielli, fasulja, orizi, makaronat etj.

Imam Ibn Kajimi (Allahu e mëshiroftë) thotë: *“Këto ishin thuajse ushqimet më kryesore në Medinë. Mirëpo, nëse në një vend apo zonë ushqimi është diç tjetër, atëherë e kanë obligim ta japin ushqimin që përdorin.*

Nëse ushqimi i tyre është jo nga drithërat, si: kosi, mishi, peshku, fitrin e tyre e japin nga ushqimi që përdorin, çfarëdo që të jetë, ky është mendimi i shumicës së dijetarëve dhe se kjo është e vërteta, e cila nuk thuhet ndryshe.

Kjo, se qëllimi është plotësimi i nevojës së nevojtarëve ditën e Bajramit dhe përkrahja e dalja në ndihmë atyre me llojet e ushqimit që përdoren në vend.

Së këndejmi, mielli lejohet të jepet, ndonëse hadithi për të nuk është i saktë. Edhe pse dhënia e bukës apo ushqimit (të

*gatshëm) mund të jetë më i dobishëm për
nevojtarët, sepse ka pak mund dhe kushton
më lirë, prapëseprapë dhënia e drithit
mund të jetë më i dobishëm për ta sepse
qëndron më gjatë.”*

A lejohet të jepen të holla në vend të ushqimit?

Dhënia e zekatit të fitrit në të holla, apo ta quajmë më mirë në vlerë të ushqimit, sepse vlera mund të jetë edhe në para e gatshme, edhe në diç tjetër, është çështje për të cilën ka mospajtime mes dijetarëve të hershëm. Shkurtimisht, aq sa kam hasur në burime e literaturë, në këtë çështje ka katër mendime:

1. Nuk lejohet. Këtë mendim mbrojnë tri medhhebet: maliki, shafi dhe hanbeli; nga bashkëkohorët: shejh Albani, Ibn Bazi, Ibn Uthejmini, Komisioni i Përhershëm për Fetva e shumë të tjerë.

2. Lejohet. Ky është mendimi i medhhebit hanefi dhe i këtyre imamëve: Sufjan eth Thevriut, Jahja ibn Meinit, e

para tyre: Hasan el Basriut. Këtë e praktikonte kalifi i drejtë, Omer ibn Abdulazizi. Po ashtu, Ebu Is'hak es Sebiiu tregon se, në kohën e tij, sipas këtij mendimi punonin në Kufe (Irak) etj. Ndërkaq, bashkëkohorët që mendojnë kësisoj janë: shejh Ahmed ibn Muhamed el Gimari në librin e tij *“Tahkikul Amal fi ihraxh zekatil fitr bil mal”* e shumë të tjerë. Në përputhje me këtë mendim punohet në shumicën e vendeve sot.

3. Lejohet vetëm në raste domosdoshmërie apo nevojë. Këtë mendim përkrahin: Ebu Theuriu dhe Is'hak ibn Rahavejhi, ndërsa nga të mëvonshmit Ibn Tejmije në njërin mendim të tij. (Shih: *Hashijetu Ravdul Murbi*, 3/206)

4. Kjo është e papëlqyer (mekruh).

Këtë mendim kishte Ata ibn Ebi Rabah, siç shënon Ibn Ebi Shejbe në *El Musanef*.

Këto janë mendimet përkitazi me këtë çështje, kurse sjellja e argumenteve dhe diskutimi i tyre zë vend, porse lusim Allahun të na lehtësojë një gjë të tillë në ndonjë publikim (punim) tjetër!

Në mbyllje të kësaj çështjeje mund të themi se, kjo është një nga çështjet në të cilat dijetarët e hershëm kanë bërë përpjekje (ixhtihad), andaj nuk është e udhës të kritikohet nëse dikush e zgjedh njërin mendim dhe lë tjetrin. Kjo, se secilin mendim që merr dhe punon me cilindo prej tyre, ka pasuar dikë prej selefëve dhe imamëve të këtij umeti, edhe pse, në raste të tilla, më mirë është të praktikohet Suneti dhe të iket nga

mospajtimi, në mënyrë që të jepet ushqim prej ushqimeve të njohura në vend, gjë kjo përmes së cilës i ikën mospajtimit, sepse, nëse jep ushqim, atëherë me këtë janë pajtuar të gjithë dijetarët muslimanë të të gjitha medhhebeve.

Imam Ebu Bekër el Ameshi, dijetar i hershëm hanefi (Allahu e mëshiroftë), duke folur se a është më mirë të jepet vlera (para) apo ushqim, ka thënë: *“Të jepet gruri është më mirë sesa të jepet vlera e tij (në të holla), sepse kjo është më afër pasimit (të urdhrit profetik) dhe më larg kundërthënieve (mospajtimeve) të dijetarëve.”* (Shih: *El Mabsut*, 3/107)

Lus Allahun të na i pranojë adhurimet tona dhe të na mundësojë t'i kryejmë ato në formën më të mirë! Amin!